

MBI STRUKTURËN LEKSIKO — SEMATIKE DHE ETIMOLOGJIKE TË TIPIT TË TOGFJALËSHIT TË SHQIPES *BURRI I DHEUT*

Ruzhdi Ushaku

Fakulteti Filozofik
Prishtinë

KUD 809. 198. 3-3
Punim studimor

Marrië për botim më 28 qershor 1988

Togfjalëshi i shqipes *burri i dheut* është konstrukt *sui generis* dhe ka luptimin e përgjithshëm *njeri trim, i ndershëm, i aftë, me karakter të fortë*. Në këtë strukturë leksiko-semantike, përcaktuesi i *dheut* është desemantizuar.

Burri i Dheut në një legjendë shqiptare emërton edhe një figurë mitike ku përcaktuesi i dheut del semantikisht më i qartë dhe i motivuar. Po këtë motivim semantik e ndeshim edhe te figura mitike *E Bukura e Dheut* (sepse „jeton në një pallat nën dhe”) me përcaktimin e karakterit ktonik të saj.

Mbështetur në këto të dhëna dhe në një mendim të qëndrueshëm, sipas të cilit etimologjia e emrit „njeri” në disa gjuhë indoevropiane lidhet me fjalën „dhë, tokë”, përmes këtij punimi synohet zbërthimi i motivimit semantik e etimologjik të togfjalëshit *burri i dheut* me mundësi rindërtimi në protoshqipe.

Në një punim paraprak mbi një gërshetim leksiko-semantik e etimologjik të shqipes, vëmendjen tonë e kemi përqëndruar, në mes tjerash, edhe në togfjalëshat e shqipes *burri i dheut* e *burri i botës*,¹ të cilët deri më tani, më se e dimë ne, nuk kanë qenë objekt i ndonjë shqyrtimi ose studimi të veçantë dhe më të thelluar. Nisma dhe paralajmërimi i një studimi të veçantë lidhur me këtë çështje disi na obligoi që të japim ndihmesën tonë me këtë rast.

Sementizmi i këtyre togfjalëshave, përkatësisht struktura e tyre leksiko-semantike na kanë tërhequr vëmendjen që t’i vështrojmë edhe në nivelin etimologjik, sidomos sa i takon motivimit të brendshëm etimologjik të vetë togfjalëshave, duke i vënë këta edhe në planin krahasues.²

Para se të shtrojmë ndonjë supozim ose të nxjerrim ndonjë përfundim lidhur me etimologjinë e këtyre togfjalëshave dhe disa të tjerëve të këtij lloji, e shohim të udhës që çështjen ta analizojmë së pari brenda fondit gjuhësor të shqipes dhe të kulturës mendore e materiale të shqiptarëve, duke pasur për pikënisje realizimin gjuhësor si pasojë e duke kërkuar shkakun e tij historik, psikolinguistik dhe etnolinguistik.

¹ Shih punimin tonë: *Ndihmesë për vështrim krahasues të një gërshetimi leksiko-semantik dhe etimologjik të shqipes* në „Gjuha shqipe” 2/1986, f. 18-19, „Jehona” 5/1986, f. 54-55.

² Në planin krahasues me disa gjuhë të tjera, përveç disa strukturave analoge, nuk ndeshim në struktura leksiko-semantike e sintaksore identike me togfjalëshat e tipit *burri i dheut*, që dëshmon se kemi të bëjmë me togfjalësha të llojit të vet që ndeshen në shqipe.

Që në fillim po e theksojmë se togfjalëshat *burri i dheut*, *biri i dheut*, *burri i botës*, *biri i botës* zënë vend të rëndësishëm dhe të qëndrueshëm në fondin e përgjithshëm leksikor të shqipes së folur dhe të shkruar, dhe zënë, vend standard në fjalorin e gjuhës shqipe. Kanë një strukturë leksiko-semanticë, të ngjeshur, pothuajse të ngurosur, dhe shprehin një nocion të caktuar e të shkrirë. Për studimin sa më të plotë e më të gjithanshëm të togfjalëshave të kësaj kategorie, mendojmë se është e nevojshme t'i vështrojmë më parë në sinkroni, duke vënë në pah si nivelin sintagmatik ashtu edhe atë paradigmatic të elementeve përbërëse leksikore që shërbejnë për të sajuar togfjalëshat e këtij tipi.

Struktura leksiko-semanticë e sintaksore

Struktura leksiko-semanticë e togfjalëshave *burri i dheut* e *burri i botës*, si strukturë e ngurosur leksikore, dhe semantizmi i tyre që kryesisht shkrihet në një koncept, dëshmojnë se kemi të bëjmë me një kategori bashkimi frazeologjik që më tepër funksionon si idiomë frazeologjike shqipe me strukturë *emër+emër (=emër)*, i pari në rolin e të përcaktuarit e i dyti në rolin e përcaktuesit. Shikuar në nivelin sintagmatik ose në boshtin paradigmatic të substituit leksikor të gjymtyrës së dytë në rolin e përcaktuesit, përveç togfjalëshave *burri i dheut* e *burri i botës*, në shqipe janë të njohur edhe togfjalëshat *burrë i besës* dhe *burrë i nënës* me përcaktues në trajtë të shquar dhe ata *burrë fjale*, *burrë zakoni*, *burrë shteti* me përcaktues të pashquar. Ndërkaq, analogjikisht me atë *burrë i besës*, ndëgjohet edhe togfjalëshi *burrë i fjalaës* me përcaktues të shquar.

Në rastin e togfjalëshave ku përcaktuesi del në një lidhje sintaksore të gjinore së pashquar, sipas ndjenjës sonë gjuhësore, më tepër kemi të bëjmë me një raport përcaktues që tregon nuancën e cilësisë ose të një përcaktimi më të përgjithësuar sesa ndonjë raport përkatësie në kuptimin më të ngushtë të fjalës, siç është rasti me përcaktuesin në trajtë të shquar. Kësodore, te togfjalëshat *burri i dheut*, *burri i botës* e analogjikisht me ta edhe te *burri i besës* e *burri i nënës*, më tepër ndiejmë-një raport përkatësie, kurse tek ata *burrë fjale*, *burrë zakoni*, *burrë shteti* dominom nacioni përcaktues më i përgjithësuar. Mendojmë se ky krahasim brenda dy nuancave të strukturës leksiko-semanticë dhe lidhjes sintaksore përkatëse mes gjymtyrëve ka rëndësi të veçantë për zberthimin e semantizimit dhe të motivimit etimologjik të togfjalëshave *burri i dheut*, *burri i botës*, *biri i dheut*, *biri i botës*, *E Bukura e Dheut* e analogjikisht me këtë të fundit edhe *Perria e Detit* (*E Bukura e Detit*), *Zana e Malit*, ku përcaktuesi vjen rregullisht pas të përcaktuarit dhe del në trajtën e shquar.

Derisa, siç u pa më lart, ndeshim *burrë fjale* krahas *burrë i fjalës*, e analogjikisht mund të dëgjohet edhe *perri deti* e *zanë mali* me një koncept më të përgjithësuar, nuk e kemi të njohur ndonjë paralelizëm të tipit **burrë dheu*, **burrë bote*, **bir dheu*, **bir bote*, **e bukur dheu*, gjë që, për mendimin tonë ka rëndësi të madhe për karakterin stabil, të ngurtësuar pothuajse të fosilizuar të strukturës leksiko-semanticë e sintaksore të togfjalëshave *burri i*

dheut, biri i dheut, burri i botës, biri i botës, E Bukura e Dheut e ndonjë tjetër të kësaj kategorie.

Në anën tjetër, *burri i dheut*, si togëfjalësh idiomatik ku përcaktuesi *dheu* shkrihet në një semantizëm tjetër që i largohet konceptit të „dheut” me kuptim *burrë i zoti, trim, burrë mbi burrë*, në shqipe përdoret dendur në funksion të thirrorit dhe ka kryesisht kuptim përfillës, emocional. Në mënyrë analoge, *burri i botës* po ashtu funksionon si një bashkim frazeologjik i ngjeshur, por me semantizëm kryesisht mospërfillës, e më tepër përçmues, me kuptim një *burrë çfarëdo, i panjohur*. Sa i takon gjymtyrës së parë të këtyre togfjalëshave duhet thënë se në boshtin paradigmatic të emrave *burri, biri, e bukura* me përcaktuesin *i dheut*, nuk e kemi të njohur ndonjë substituum më të rregullt të tipit **bija e dheut* e sidomos **gruaja e dheut*, siç është rasti me përcaktuesin „i, e botës” në togfjalëshat e zakonshëm të shqipes *bija e botës* dhe *gruaja e botës* me kuptim përçmues të një vajze ose gruaje çfarëdo, të panjohur.

Me një lidhje të tillë sintaksore dhe me strukturë të ngjashme leksiko-semantike në shqipe njihen edhe emërtimet (togfjalëshat) *Burri i Dheut, E Bukura e Dheut* për figurat përralore-folklorike, të cilat i ndeshim në traditën folklorike të shqiptarëve.

Në këtë kontekst e shohim të udhës t’i sillemi edhe semantizimit të togfjalëshave-emërtimeve *Burri i Dheut* dhe *E Bukura e Dheut* si tërësi konceptuale në njërin anë, por edhe semantizimit të përcaktuesit „i, e dheut” në këto emërtime, në dallim prej togfjalëshave të cekur më lart *burri i dheut, biri i dheut*.

Në një burim folklorik që ka të bëjë me legendën mbi *Krojet e Sumës*,³ përmendet disa herë figura mitike-përralore me emër *Burri i Dheut* që paraqitet si një qenie e fuqishme e misterioze që del e lëviz natën, e kur ky ecën „dridhet toka prej tij.”⁴ Togfjalëshi *Burri i Dheut* në këtë legendë del me një semantizëm të nuancuar dhe me një motivim semantik-etimologjik me të tejdukshëm se togfjalëshi i përgjithëshëm i shqipes *burri i dheut* me kuptimin e cekur më lart. Rrjedhimisht, edhe përcaktuesi i *dheut*, në emërtimin e kësaj figure mitike-folklorike, del me një semantizëm më të qartë e më konkret të „dheut” kur kihet parasysh varshmëria konceptuale e gjymtyrës *burri* me gjymtyrën *dheu* në kontekstin e legendës. Mendojmë se përcaktuesi *i dheut* në këtë emërtim më tepër i afrohet semantizmit të po këtij përcaktuesi në togfjalëshin-emërtimin e mirënjohur *E Bukura e Dheut* për figurën aq të njohur të përrallave shqiptare, e cila shfaqet si një vashë shumë e bukur „që rri në një pallat nën dhe.”⁵ Semantizmi i këtyre togfjalëshave që emërtojnë figura të përrallave shqiptare zërthehet pra në një lidhje më të qartë, më kon-

³ Shih punimin e magistraturës në dorëshkrim: M e j r e m e M a r a j, *Përrallat popullore shqiptare në trevën e Ulqinit, Shtojit, Anës së Malit dhe Krajës*, Prishtinë, 1986, f. 205-206.

⁴ *Po aty*.

⁵ Shih: *Fjalori i Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 1954, f. 50 (ribotim Rilindja, Prishtinë, 1965); *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Prishtinë, Rilindja, 1981, I, 194; *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar*, Tiranë, 1961, I, f. 259, 268, 285, II, f. 170; *Përralla II*, Prishtinë, Instituti Albanologjik, 1982, f. 189-191 (Peshkatarit dhe e bukura e dheut).

krete, me konceptin e „dheut, tokës”. Po me këtë kuptim të përgjithshëm të figurave përralore-folklorike në shqipe përdoren edhe emërtimet e *E Bukura e Jetës për E Bukura e Dheut* dhe *I Bukuri i Dheut*,⁶ kurse të Bardhi për Tellus, Dea të lat. gjejmë *Zonja e dheut*.⁷ Këto të dhëna, na thotë mendja, kanë rëndësi e vet edhe për zbërthimin e motivimit etimologjik të togfjalëshave *burri i dheut, biri i dheut* për çka do të bëjmë fjalë në vazhdim të këtij punimi.

Shikuar në një prerje diakronike, nuk ka dyshim se *Burri i Dheut* dhe *E Bukura e Dheut*, si emërtime të figurave përralore-mitike, duhet të shpiejnë thellë në lashtësi, e kjo vlen veçanërisht për dendurinë dhe vazhdimësinë e shfaqjes së figurës përralore-folklorike me emër *E Bukura e Dheut* në traditën gojore dhe folklorin shqiptar.⁸ Ndërkaq, *burri i dheut* me kuptimin e përgjithshëm që e ka sot si dhe *biri i dheut*, togfjalësha këta të fondit të përgjithshëm të gjuhës shqipe, ndeshen në burime leksikografike të shqipes, relativisht të hershme,⁹ dhe në burime të tjera, relativisht të vjetra, të shqipes së shkruar, në raste kur konteksti ose rrethanat e shkrimit e kanë kërkuar përdorimin e tyre. Kështu Vaso Pasha shënon disa herë sintagmën ose togfjalëshin *fils de la terre*,¹⁰ përkatësisht bën fjalë për „një pellazg të parë, të *bir'e dheut* (nënvizimi ynë)”,¹¹ kurse në shkrimet e tij përdor sintagmën *burra e dheut*. Kristofordhi, po ashtu, e përdor sintagmën-togfjalëshin *burri i dheut* me kuptimin e përgjithshëm që e ka në shqipe, e me këtë kuptim e shënon edhe në *Fjalorin shqip-greqisht*.¹² Në tekstin e *Kanunit të Lekë Dukagjinit* ndeshen ndërtimet *Burrat e dheut, Djelmni e dheut* e analogjikisht me to edhe *Burrat e Maleve*.¹³ Togfjalëshi *burri i dheut, biri i dheut* shënohet me një vazhdimësi edhe në fjalorët standardë dhe ata frazeologjikë të gjuhës shqipe.¹⁴ Në *Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe* (v. 1981) gjejmë edhe togfja-

⁶ Shih *Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe* cituar më lart, I, f. 194.

⁷ Shih: F. B l a n c h u m, *Le Dictionnaire albanais de 1635*, Paris, Paul Geuthner, 1932, f. 171.

⁸ Është fjala për të *Bukurën e Dheut* që ndeshet në përrallat shqiptare që nga mbledhësit më të hershëm të folklorit shqiptar me tituj si *E Bukura e Dheut, Kuçedra dhe e Bukura e Dheut, Peshkatori dhe e Bukura e Dheut* e të tjera. Ky emërtim-togfjalësh *e bukura e dheut* shënohet edhe në *Fjalorin e Hanit* (J. G. v o n H a h n, *Albanesische Studien Heft III-Albanesisch-Deutschen Lexicon*, Jena, 1854, f. 16) si dhe në *Fjalorin shqip-greqisht* të K. Kristoforidhit (K. K r i s t o f o r i d h i, *Fjalor shqip-greqisht*, Prishtinë, Rilindja, 1977, f.57).

⁹ Mëndohet në fjalorët e shqipes, ose shqip-gjuhë e huaj ku fillojnë të figurojnë, përveç fjalëve të thjeshta, edhe togfjalësha, kompozita e frazeologji të ndryshme.

¹⁰ Shih në: V a s s a E f f e n d i, *La vérité sur l'Albanie et les Albanais*, Paris, Iprimerie de la Société anonymede publications périodiques, 1897, f. 7, 8 (Palesgus appelé fils de la terre).

¹¹ Shih në: V a s s a E f f e n d i, *E vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët* (përkthim dhe komentim prej Mehdi Frashërit), Tiranë, Shtypur në Shtypshkronjën „Tirana”, 1935, faqe 9 et passim.

¹² Në „Gjahun e Malësorëve” e ndeshim këtë togfjalësh në funksion të apostrofit ose të thrrorës: -Urdhëro, o burr' i dheut (nënvizim yni). Shih edhe *Fjalorin e cituar të K. Kristoforidhit*.

¹³ Shih në: *Kanuni i Lekë Dukagjinit* (përmbledhur dhe kodifikuar nga Shtjefen Gjeçovi), Prishtinë, Etni i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të KSA të Kosovës, 1972, f. 100-101.

¹⁴ Shih *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* të vitit 1954, *Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe* të cituar më lart; M . G j e v o r i, *Frazeologji shqipe*, Prishtinë, Rilindja, 1968 f. 53 (ku gjejmë *burrë i dheut* me kuptim 1. trim, dhe 2. *biri i botës*).

lëshin *trimat e dheut* i cili mund të merret edhe si sinonim i atij *burrat e dheut*. Po në këtë fjalor shënohet edhe togfjalëshi *bindi i dheut*, ndërsa te Gazulli gjejmë të shënuar, krahas *Bindi i Zotit për mirabile Dei*, edhe shprehjen *ishte bindi i tokës* me kuptim *mrekulli* (e tokës R. U.)¹⁵, çka flet në të mirë të një strukture leksiko-semantike e sintaksore të tyre mjaft të qëndrueshme e pa dyshim të vjetër.

Vlen të ceket me këtë rast se, sipas një kumtimi gojor (nga Mehmet Ahmetaj) në Plavë e Guci dëgjohen dendur edhe togfjalëshat *burrnesha e dheut* dhe *bija e dheut*.

Derisa togfjalëshin *Burri i Dheut* me kuptimin e figurës mitike -përrallore e ndeshim në legjendën e përmendur më lart, togfjalëshin *E Bukura e Dheut* me kuptimin e figurës përrallore e ndeshim edhe në Fjalorin e Hanit (Hahn)¹⁶, në Fjalorin e Kristoforidhit dhe me vazhdimësi në fjalorët standardë të gjuhës shqipe, kurse vetë figura përrallore-mitike me emërtim *E Bukura e Dheut*, përveç në traditën gojore të shqiptarëve, ndeshet në shumë përralla të mbledhura e të shënuara prej mbledhësve më të hershëm të folklorit shqiptar¹⁷ e deri në ditët tona. Këto të dhëna etnolinguistike në sinkroni dhe diakroni dëshmojnë se togfjalëshat e sipërpërmendur me përcaktuesin **dhe** janë pjesë e pandarë e traditës, kulturës mendore e materiale të shqiptarëve dhe kryesisht, për nga struktura leksiko-semantike dhe rendi i gjymtyrëve, janë karakteristike për gjuhën shqipe.

Struktura etimologjike e togfjalëshave „burri i dheut, biri i dheut” dhe „Burri i Dheut, E Bukura e Dheut”-

Në njërën anë, siç shihet, kemi të bëjmë me togfjalëshat e njohur të shqipes **burri i dheut, biri i dheut** me kuptimin e përgjithshëm që e kanë sot, dhe në anën tjetër me figura mitike-folklorike që në traditën gojore-folklorike të shqiptarëve emërtohen *Burri i Dheut, E Bukura e Dheut*. Në të gjitha këto ndërtime figuron fjala *dhe*, përkatësisht përcaktuesi *i, e dheut*, si i desemantizuar në togfjalëshat *burri i dheut, biri i dheut* dhe me një semantizëm më të tejdukshëm në emrat e figurave mitike-folklorike *Burri i Dheut, E Bukura e Dheut*. Këto të fundit, si emërtime për koncepte të figurave mitike-folklorike pa dyshim të lashta, mund të na ndihmojnë edhe zbërthimin e motivimit etimologjik të togfjalëshave *burri i dheut, biri i dheut*. Andaj për origjinën ose motivimin etimologjik të ndërtimeve që u zunë në gojë është me rëndësi të bëhet fjalë edhe për origjinën e lashtë të gjymtyrëve të tyre *burrë, bir* e veçanërisht të përcaktuesit të përbashkët *dhe (i dheut, e dheut)*. Në studimet etimologjike në fushë të shqipes fjala *dhe, dheu* nuk ka qenë objekt i ndonjë studimi etimologjik të veçantë dhe më të

¹⁵ D. Nikollë Gazulli, *Fjalorth i ri*, Tiranë, 1941, ribotim Rilindja, Prishtinë, 1968, f. 62.

¹⁶ Shih J. G. von Hahn, *Albanesische...*, f. 16.

¹⁷ Shih shënimet nën 8.

plotë,¹⁸ ndonëse ka pasur përpjekje që kjo fjalë e shqipes të lidhet, mendojmë me arsye, me një origjinë antike.¹⁹ Kështu E. Çabej lidhur me këtë çështje konfirmon me një rast se „dija e mëpastajme me mendimin e shprehur që te J.G Hahni (1854, I, f. 251) që emri i hyjnisë Δημήτηρ si 'nënë e dheut' (ose 'toka mëmë') të ketë lidhje me shq. dhê-u, e ka të pranuar.”²⁰ Po ky dijetar, duke bërë fjalë për disa konkordanca trako-shqiptare në një mbishkrim trakisht përmend edhe mendimin e Georigievit sipas të cilit pjesa Δ Α e mbishkrimit ΔΑΔΑΛΕΜΕ ka lidhje me shqipen *dhe-u*.²¹ Këto konstatime që fjalën *dhe-u* të shqipes e shpiejnë në një kohë shumë të lashtë, kanë rëndësi të madhe jo vetëm për etimologjinë e fjalës *dhe*, *dheu*, të shqipes por edhe për shpjegimin e motivimit etimologjik të togfjalëshave e të emërtimeve të zëna në gojë, përkatësisht për rindërtimin e tyre në lashtësi. Duhet cekur se, sipas disa dijetarëve, fjala *dhe* e shqipes zë vend në kontekstin e gjuhëve indoevropiane, nga një bazë e supozuar **dhe* (*e*)-*ghom*.²² Në disa gjuhë të tjera indoevropiane emri „dhe, tokë” vihet në raport me rrënjën i.e. *khem* - me kuptim *tokë*, *dhe* që në sanskritishte është *ksam*, greqisht *khthôn*, latinisht *humus*.²³ Edhe në gjuhët sllave, emri i *tokës*, *dheut* lidhet me rrënjën indoevropiane **ghdem-*, e që gjendet në emrin frak-frigjik të perëndeshës së tokës *σεμελωσ* gr. *Σεμελη*.²⁴ Këto të dhëna mendojmë se kanë rëndësi të veçantë, sepse, siç shihet, edhe në shumë gjuhë indoevropiane fjala „dhe, tokë” lidhet me rrënjë të lashtë indoevropiane, përkatësisht me emrat e hyjnive që shpiejnë thellë në mitologji. Me këtë rast vlen të përmendet se fjala greke *χθων/χσόνοσ* në mendimin grek tregon një fuqi të parë themelore (primitive) ashtu që kjo „Khthôn” është bërë nëna e Titajve në mitologjinë më të hershme të formimit të universumit dhe gjen një plotësues në emrin *γη* që më tepër konsiderohet si element tokësor i cili i kundërvihet *detit*, *ajrit*. Kështu *γη* sot gjendet në fjalët konkrete, fjalëformimet më të vonshme si *gjeografi*, *gjeologji*, *gjeomorfologji* e tjera të kësaj natyre, me kuptim më tepër fizik e shkencor, dhe si e tillë përdoret në shumë gjuhë. Në disa shkrime më të hershme vërehet një prirje për të hetuar një afri mes fjalës *γη* të greqishtes me atë *dhe* të shqipes, më tepër në bazë të gjasisë sesa të një analize më të hollësishme e më të plotë filologjike-gjuhësore.²⁵ Kështu mbetet e hapur dhe e paprecizuar çështja etimologjike e cila do

¹⁸ Në studimet etimologjike në fushë të shqipes të E. Çabejt (Studime gjuhësore I, II, Prishtinë, Rilindja, 1976) nuk trajtohet etimologjia e fjalës *dhe*.

¹⁹ Shih në: E. Çabej, *Studime gjuhësore IV*, Prishtinë, Rilindja, 1976, f. 342.

²⁰ Po ai, *po aty*.

²¹ Po ai, *po aty*, f. 123-124.

²² Shih lidhur me këtë: X. Delamarre, *Le vocabulaire indo-européen. Lexique étymologique thématique*, Paris, Librairie d'Amérique et d'Orient Maisonneuve, 1984, f. 181.

²³ R. Grandaignes d'Hauteville, *Dictionnaire des racines des langues européennes*, Paris, Librairie Larousse, s. a., f. 91.

²⁴ Shih Petar Skok, *Etimologijski rječnik hrvatskoga ili srpskog jezika*, III, Zagreb, JAZU, 1973, f. 650.

²⁵ Shih te: Vassa Effendi, *La vérité sur l'Albanie...*, f. 25; Demetrio Camarda, *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Livorno, Successore di Egisto Vignozzi e G., 1864, f. 21, 46, 134.

ta afronte fjalën $\gamma \eta$ të greqishtes me atë *dhe* të shqipes, e të cilat, në anën tjetër, siç u pa më lart, nuk vihen në ndonjë raport me fjalën *khthon* të greqishtes, përkatësisht me rrënjën *khem-* të indoevropishtes me kuptim *tokë, dhe*.

Në këtë kontekst mendojmë se meriton vëmendje dhe trajtim më të plotë edhe afria e fjalës *dhe* të shqipes me atë $\gamma \eta$ të greqishtes, aq më parë kur dihet se sot ka intenca të ringjallet teoria sipas së cilës greqishtja ka fjalë të një substrati indoevropian.²⁶ Në mungesë të dokumenteve më të vjetra të shkruara mendojmë se mund t'i referohemi mendimit të Hanit (Hahn) mbi fjalën *dhe* të shqipes në emrin e *Demetrës* greke,²⁷ e lidhur me këtë, fjalën *de* (dhe) të parashqipes ta afrojmë edhe atë $\nu \eta$ të greqishtes kur dihet se shqipja *k-në* paletale e ka shëndrruar në *th e g-në* në *dh* ose *d*, e për këtë paralelizëm të *dh-së* shqipe që i përgjigjet *g-së* greke kemi fjalën greke $\gamma \alpha \mu \beta \rho \acute{o} \varsigma$ (gambros) dhe i përgjigjet latinishtes *gener* e shqipes *dhëndër*, pastaj atë $\gamma \acute{o} \mu \rho \acute{o} \varsigma$ (gomphos) që në shqipe e kemi fjalën përkatëse *dhamb, dhëmb*, që është në pajtim me zhvillimin fonetik-fonologjik të shqipes në kuadrin e gjuhëve indoevropiane të grupit satem.²⁸ Andaj, nëse e kemi parasysh praninë e fjalës *de* (dhe) të parashqipes në emrin e *Demetrës*, nuk ka arsye që të mos afrohen fjala $\gamma \eta$ e greqishtes me atë *dhe* apo *de* të parashqipes, aq më parë kur dihet se greqishtja e ka fjalën *khthôn* e cila emërton *dheun* në kuptimin më të gjërë të fjalës, por edhe në kuptimin mitologjik, kështu që për *ge* e *khthôn* mund të flitet edhe si për sinonime të krijuara e të përdorura në rrethana të ndryshme historiko-shoqërore. Duke e afruar në një mënyrë fjalën $\gamma \eta$ me atë *dhe*, përkatësisht me atë *de* në emrin e *Demetrës*, vlen të theksohet se perëndesha greke Gjea në mitologjinë greke tregon *tokën nënë dhe, në thelb, nuk largohet nga Demetra* ($\Delta \eta \mu \eta \tau \eta \rho$) *nëna tokë* mitologjike si ndër hyjnitë më të vjetra greke, kulti i së cilës më vonë shkrihet në atë të Gjeës.

Të gjitha këto të dhëna duket se na japin dorë, duke pasur parasysh se fjala *dhe* e shqipes lidhet me një nënshtresë indoevropiane, që këtë fjalë të shqipes a të parashqipes ta kërkojmë në kohët më të lashta. Përveç të dhënave filologjike antike mbi këtë fjalë, mendojmë se për një pohim të tillë mund të kemi mbështetje edhe në kriteret jashtëgjuhësore, sociologjike, etnologjike, psikologjike, meqë fjalët *dhe, ujë, det* e ndonjë tjetër e kësaj natyre ose kategorie, për arsye ekonomike, shoqërore, religjioze duhet të jenë të vjetra sa edhe vetë etnosi i caktuar, sa edhe vetë shoqëria e caktuar, madje pothuajse sa edhe vetë njeriu dhe emri i njeriut. Këtë mund ta dëshmojë fakti se asnjë mbishtresë e kulturave që kanë ushtruar ndikimet më të mëdha në shqipes ose parashqipe siç janë ato *khthôn e ge* e greqishtes, *terra* ose *humus* e

²⁶ Shih E. Ç a b e j, *Disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe* në: Konferenca e parë e studimeve albanologjike, Tiranë, USHT — Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1965, f. 99.

²⁷ Po ai, *po aty*.

²⁸ Shih E. Ç a b e j, *Studime gjuhësore VII*, Prishtinë, Rilindja, 1986, f. 51-52, 80-81.; V R i m o h o v s k i, *Kërkime mbi historinë e sand'hit në gjuhën shqipe*, në „Gjuha shqipe” 2/1987, f. 26-31.

latinishtes, *zemlja* e sllavishtes nuk arritën ta çrrënjosin stabilitetin dhe dendurinë e përdorimit të fjalës *dhe* në shqipe. Andaj ka arsye që kjo fjalë e shqipes të vendoset në fondin e fjalëve më të vjetra të parashqipes ose të periudhës indoevropiane që njëheri i takojnë periudhës së hershme mitologjike të zhvillimit të shoqërisë e të gjuhëve e kulturës indoevropiane, pa marrë parasysh trajtën e sotme *dhe* si pasojë e një evoluimi ose ndryshimi të vogël në nivelin morfologjik-fonetik.

Duhet shtuar se fjala *dhe* e shqipes për emërtimin e *dheut*, *pluhurit*, *tokës*, pastaj me kuptim më të gjërë të *vendit*, *atdheut*, *gjindes*, është një ndër fjalët më të zakonshme dhe me përdorim më të dendur në gjuhën shqipe, dhe e cila ndeshet që nga shkrimet e para shqipe, prej Buzukut e deri në ditëttona, kurse F. Bardhi fjalën *terra* të latinishtes e përkthen me atë *dhe* të shqipes.

Për ta dëshmuar sadopak karakterin primitiv-religjioz të konceptit „dheut”, „tokës”, e lidhur me të edhe të fjalëve *dhe*, *tokë*, duhet cekur se, që nga kohët më të lashta, jeta dhe vdekja e njeriut ka qenë lidhur me *dheun*, *tokën*, prandaj si ekzistenca, si rituali i varrimit, e lidhur me këto edhe emërtimet gjuhësore e kanë ndjekur doemos këtë realitet. Kështu, sot e kësaj dite, lidhur me *dheun*, *tokën*, ndeshen relikte të karakterit mitologjik, mitik e religjioz, që janë ruajtur në formula dhe realizime të ndryshme gjuhësore të shqipes. Është e njohur se një ndër betimet më të vjetra të shqiptarëve është betimi mbi *dheun*, *tokën*, *gurin*, *malet* që na rikujton, në thelb, betimin që bënin popujt e vjetër në emër të hyjnive të ndryshme. Ndër shqiptarë është e njohur e ashtuquajtura „beja më gur” „beja mbi gur” „beja e Maleve” ose betimi „Për këtë gur e dhe!”, si betime me karakter pagan që ndeshen të shënuara edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit,²⁹ kurse Hani (III, 25) shënon betimin „Për këtë gur e dhe!”, që vetvetiu nënkuptojnë betimin drejtuar hyjnive pagane primitive, në vend të betimit të zakonshëm në perëndi ose zot. Në shqipe është i njohur edhe togfjalëshi *Guri i besë* (gur mbi të cilin betoheshin), pastaj shprehja e njohur *besën (amanetin) se tret dheu, amanetin se kalb dheu* që nënkuptojnë madhështinë, të thuash mitologjike ose mitike të dheut. Në shqipe janë ruajtur edhe shumë formula mallkimi siç janë: „Të përpiftë dheu!”, „E hëngërt dheu!” e analogjikisht me to edhe „Të gzoftë toka!”, „Të shtifsha në dhe!” e ndonjë tjetër. Karakteristike është edhe shprehja „E hëngri dheu”, „Dheu na mban, dheu na han”. Si betimet ashtu edhe mallkimet dhe shprehjet e tjera lidhur me *dheun*, *tokën*, *gurin*, *malet*, na rikujtojnë reliktet e hyjnive pagane prej kohëve më të lashta, siç ishin betimet e grekëve të vjetër në Demetrën dhe Gjeën. Analogjikisht edhe fjala *dhe* e shqipes në këtë kontekst na shpie drejt një origjine të lashtë të përdorimit të saj në parashqipe e lidhur me këtë edhe togfjalëshat që u zunë në gojë, duke pasur parasysh jo vetëm përcaktuesin *dhe*, po edhe gjymtyrët e përcaktuara *burrë*, *bir*, *bind*, *E bukura*, si të pandara nga struktura e togfjalëshave ose emërtimeve *burri i dheut*, *biri i dheut*, *bindi i dheut*, *E bukura e*

²⁹ Shih në *Kanuni i Lekë Dukagjinit* cituar më lart, f. 37,60; E . Ç a b e j, *Studime gjuhësore V*, Prishtinë, Rilindja, 1975, f. 342.

Dheut, Burri i Dheut, që do të na shërbejnë për zbërthimin e motivimit etimologjik. Kjo do të vrente edhe për gjymtyrët e përcaktuara *burrnesha* dhe *bija* te togfjalëshat *burrnesha e dheut* dhe *bija e dheut* që përdoren në ndonjë të folme të shqipes.

S' do mend se si togfjalësha më karakteristike dhe me përdorim më të dendur janë ata *burri i dheut* dhe *biri i dheut*, prandaj edhe etimologjia e fjalës *burrë*, *bir* të shqipes ka rëndësinë e vet për zbërthimin etimologjik të togfjalëshave gjegjës dhe rindërtimin e tyre në parashqipe. Sa i takon fjalës *burrë* të shqipes kryesisht dominojnë mendimet për një etimologjitë lashtë të saj.³⁰ Kjo ka rëndësi të veçantë edhe për lashtësinë e togfjalëshit, kurse konstatimi i E. Çabejt se fjala shqipe *burrë* në thelb nuk është një emër afrie dhe ka pasur dikur kuptimin „zot”³¹ mund të ndihmojë shumë për zbërthimin e motivimit semantik-etimologjik të togfjalëshit *burri i dheut*.

Disa dijetarë kanë synuar ta afrojnë fjalën *burrë* me emrin personal ilir *Burius*, me atë të fisit trak *Buroi*, me qytetin *Buridava* e me *Buris* (emër burri),³² ose me emrin personal ilir *Burnio* të papranuar nga Çabej.³³ Në kontekstin e këtyre afrimeve të fundit, e me qëllim të cytjes së mendimit, mund të shtohet se, shikuar nga kriteri morfologjik si edhe ai gjeografik e historik, fjala *burrë* e shqipes do të ishte e afërt edhe me emrin personal *Burrus* (Burrum), që ceket si trajtë arkaike për atë *Pyrrhus* (Pyrrhum),³⁴ për të cilin, në dallim prej atij *Pyrrhus* (*Pirro*-i quajtur kështu për shkak të flokëve të kuqe), nuk e dimë të këtë ndonjë shpjegim etimologjik lidhur me domethënien e kësaj trajte (*Burrus*). Një afrim i fjalës *burrë* të shqipes me trajtën arkaike *Burrus* të cekur më lart, mund të jetë i arsyeshëm edhe nga fakti se emrat e shumë sundimtarëve dhe personave, si emra vetjakë në antikë, siç mendohet, ishin të motivuar nga emra të përgjithshëm siç mendohet për emrin *Teuta* (=popull)³⁵ dhe atë *Agron* (=kullotë, tokë bujqësore).³⁶ Andaj edhe emri *Burrus* (Burrum) si emër arkaik për atë *Pyrrhus* (Pyrrhum) që e përdornin në kohën romake, mund të lidhet edhe semantikisht me etimologjinë e fjalës *burrë* me kuptim „burrë i lirë”; bujk, fshatar”; „zotëri, zotni”, si kuptimet më të pranueshme lidhur me etimologjinë e fjalës *burrë*.³⁷ Sido që të jetë, fjala *burrë* e shqipes shpie në një

³⁰ Shih E. Çabej, *Studime gjuhësore I*, f. 84-85; Po ai, *Studime etimologjike në fushë të shqipes II*, A-B, Tiranë, ASHRPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1976, f. 389-391.

³¹ Po ai, *po aty*. Krahaso edhe *Zonja e dheut* shënuar nga F. Bardhi.

³² Po ai, *po aty*; E. Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë Rilindja, 1976, f. 31.

³³ Po ai, *Studime gjuhësore I*, f. 84-85; *Studime etimologjike...*, f. 389-391.

³⁴ Shih Felix Gaffiot, *Dictionnaire illustré latin-français*, Paris, Hachette, 1934, f. 232; D. Camarda, *Saggio di grammatologia...*, I, f. 51.

³⁵ K. Oštir, *Vorindogermanische (=alordische) Zahlwörter auf dem Balkan* në: Arhiv za arbansku starinu, jezik i etnologiju III, Beograd 1926-München 1971, f. 150; M. Budimir, *Ilirski tragovi u „Ilijadi”, në „Politika”, 10. VIII. 1985.*

³⁶ V. Cimochofski, *Pozicioni gjuhësor i ilirishtes ballkanike në rrethin e gjuhëve indoevropiane* në: *Studime ilire II*, Prishtinë, Rilindja, 1978 (marrë nga libri *Kuvendi i parë i studimeve ilire II*, Tiranë, 1974) f. 61. Për rrënjën i. e. *agr-* shih edhe te Grandsaignes d'Hauterive, *Dictionnaire des racines...*, f. 2.

³⁷ Shih te E. Çabej, *Studime etimologjike...*, f. 389; Po ai, *Studime gjuhësore I*, f. 84-85.

etimologji nga kohët më të lashta dhe është e arsyeshme që e ndeshim relativisht shumë herët në gjurmët onomastike dhe të shkrimit shqip.

Kështu në vitin 1335 fjalën *burrë* të shqipes e ndeshim si patronim *Burrëmadh* (Paulus Burmad) dhe si emër të një bashkësie barinjsh *Burmaza*, *Burmazoviqi* që përmendet në Hercegovinë që nga fillimi i shekullit XIV e të cilat K. Jireçeku i shpjegon, mendojmë me të drejtë, më fjalët shqipe *burrë i madh*.³⁸ Në Fjalorin e F. Bardhit e gjejmë fjalën *burrë* të shqipes për atë *maritus* të latinishtes, pra me kuptim më të ngushtë *bashkëshort*, kurse për *vir* të latinishtes gjejmë atë *njeri* të shqipes. Dh. Kamarda (D. Camarda) fjalën *burrë* të shqipes e barazon me *uomo* të italishtes dhe *vir* të latinishtes, duke e vënë (këtë të fundit R. U.) në lidhje me sanskritishten *var-as*.³⁹ Se fjala *burrë* e shqipes, në thelb, nuk është emër afrie dhe e ka kuptimin e përgjithshëm të një *mashkulli të pjekur me cilësi pozitive*, dhe si e tillë barazohet kryesisht me kuptimin që e ka fjala *vir* e latinishtes, e dëshmon edhe afria e fjalëformimeve shqipe mbi bazën e fjalës *burrë* e cila përkon me fjalëformimet latine mbi bazën e fjalës *vir* siç janë fjalëformimet latine dhe ato gjegjëse të shqipes *virago* (=burrëreshë, grua e guximshme), *virilis* (=burrëror), *virilitas* (=burrëri), *virtus* (=trimëri), e lidhur me këtë edhe *vir* (virorum) e latinishtes e ka kuptimin e *trimave të dheut*, *burrave të dheut*.

Edhe fjala *bir*, *biri* e shqipes ndeshet në dokumentet më të vjetra të shqipes së shkruar që i njohim deri më sot. E ndeshim që në vitin 1462 (Formula e pagëzimit) bashkë me fjalën *ati* (=baba), prandaj është e arsyeshme që edhe fjala *bir*, *biri* sikurse edhe ajo *burrë*, *burri*, *ati*, ajo *njeri* (që shënohet në vitin 1497 në Fjalorin e Fon Harfit), si fjalë themelore të vokabularit të jetës shoqërore, familjare, fisnore të jenë të vjetra sa edhe vetë etnosi, shoqëria dhe vetë lindja e një gjuhë. Këtë më së miri e dëshmojnë fjalët e kësaj kategorie, siç janë *ati*, *njeri* e *sidomos* ajo *motër* që vihen në raport me fjalët gjegjëse të fondit indoevropian në gjuhët indoevropiane.

Nga kjo rrjedh se si fjala *dhe* ashtu edhe ajo *burrë*, *bir* i takojnë, pa dyshim, fondit të fjalëve më të vjetra të shqipes ose të parashqipes, e lidhur me to ka gjasa që edhe lidhur me togfjalëshat *burri i dheut*, *biri i dheut*, siç do ta shohim më vonë, të bëhet ndonjë zberthim më i përpiktë etimologjik-semantik dhe rindërtim në lashtësi.

Edhe fjala *bind* e togfjalëshit *bindi i dheut* meriton vëmendje të veçantë jo vetëm sa i takon etimologjisë,⁴⁰ por edhe nga fakti se te Gazulli ndeshim togfjalëshin *Bindi i Zotit* (për lat. mirabile Dei) dhe shprehjen *Ishte bindi i tokës* (=nji mrekulli), ku shohim në një rën anë një opozicion *Bindi i dheut* me *Bindi i Zotit* dhe, në anën tjetër një zëvendësim të përcaktuesit *i dheut* me atë *i tokës* (*bindi i dheut/bindi i tokës*) që nuk është rasti me

³⁸ Shih. V. Čorović, *Napomene o albanskim tragovima u Hercegovini* në: Arhiv za arbanasku starinu..., I, Beograd, 1923-München, 1971, f. 202; E. Çabej, *Studime gjuhësore VI*, Prishtinë, Rilindja, 1977, f. 9.

³⁹ Shih te D. Camarda, *Saggio di grammatologia...*, I, f. 50, 59.

⁴⁰ Shih E. Çabej, *Studime gjuhësore I*, f. 66-67.

togfjalësha *burri i dheut*, *biri i dheut*, për të cilët nuk e kemi të njohur ndonjë strukturë * *burri i tokës*, * *biri i tokës*.

Burri i Dheut dhe *E Bukura e Dheut* si emërtime të figurave folklorike mitike, për nga motivimi semantik dhe lidhshmëria e brendshme funksionale-semantike dallohen prej togfjalëshave *burri i dheut*, *biri i dheut*, që dalin si të tillë me kuptim të shkrirë. Kështu fjala *burrë* dhe *e bukura* në emërtimet *Burri i Dheut* dhe *Bukura e Dheut* e bashkë me to edhe përcaktuesi *dhe* më tepër na interesojnë, në radhë të parë si koncepte veç e veç, pastaj edhe si koncepte brenda konceptit të këtyre emërtimeve si motivim i brendshëm semantik dhe etimologjik.

Pa marrë parasysh se sa mund të mbetet e hapur çështja e etimologjisë së fjalës *burrë* e *bir* të shqipes, është i pamohueshëm fakti se ato dëshmohen në dokumentet më të vjetra të shqipes së shkruar dhe përdoren vazhdimisht e me denduri të madhe në gjuhën e folur dhe të shkruar deri në ditët tona. Andaj nuk mund të dyshohet që termi-nocioni *burrë*, *bir*, si fond i një vokabulari bazë të jetës shoqërore, qoftë edhe me ndonjë nauncim morfologjik-fonologjik e semantik, të jetë përdorur prej kohëve më të lashta e deri në ditën tona, kurse brenda togfjalëshave *burri i dheut*, *biri i dheut* po ashtu të ketë shkuar paralel me termin-nocionin e përcaktuesit *dhe*. Po kjo do të vlente edhe për emërtimin e figurave përrallore-mitike *Burri i Dheut* dhe *E Bukura e Dheut* të cekura më lart, e sidomos për atë *E Bukura e Dheut*, të cilën, të paktën si koncept ose ndërtim konceptual, mund ta kërkojmë në kohët më të lashta. Për një supozim të tillë na duket se mund të gjejmë mbështetje, në radhë të parë, nëse togfjalëshin, përkatësisht figurën e të *Bukurës së Dheut*, e vështrojmë në planin krahasues. Në këtë kontekst duhet të kemi parasysh se figura e të *Bukurës së Dheut* në folklorin shqiptar del me një semantizëm që zbërthehet lehtë dhe i takon traditës më të lashtë gojore-folklorike shqiptare.⁴¹ Në planin krahasues vlen të theksohet se figura e të *Bukurës së Dheut* ndeshet edhe në traditën folklorike të disa popujve të tjerë të Ballkanit, por edhe më gjerë (te grekët, rumunët, maqedonasit, bullgarët, turqit e italianët). Kështu, bie fjala, rumunët e quajnë *musata locului*, maqedonasit e bullgarët *uba'ata na svetot*, turqit *dunjagüzeli* e italianët *la bella del mondo*.⁴² Na duket se struktura leksiko-semantike e konceptuale e emërtimit shqip *E Bukura e Dheut* e jo * *E Bukura e Botës*, semantikisht-etimologjikisht është më e afërt konceptit të kësaj figura përrallore-mitike, pra konceptit më të lashtë, sidomos nëse e kërkojmë gjenezën e kësaj figure mitike-përrallore në lashtësi. Lidhur me këtë po cekim se Maksimilian Lamerci (Maximilian Lambertz) e nxjerr natyrën e dyfishtë të saj „siç e ka toka mëmë edhe në mitet e popujve të tjerë. Ajo është perëndesha e nënëbotës së errët dhe njëkohësisht e çeljes gazmore të tokës në paraverë, një Persefone-Demetër shqiptare.”⁴³ Sipas Lamercit jepen tri anë

⁴¹ Shih shënimin nën 8.

⁴² Shih te K r . S a n d f e l d, *Linguistique balkanique*. Problèmes et résultats. Paris, Klincksieck, 1930, f. 161.

⁴³ Sipas citimit të E . Ç a b e j t, *Studime gjuhësore V*, Prishtinë, Rilindja, 1975, f. 120, shënimi 81.

të qenies përrallore të së *Bukurës së Dheut*, e një ndër to, që për çështjen e shtruar këtu ka rëndësi të veçantë është siç thuhet, „gjenitivi e *dheut*” me interpretim „e bukura e *dheut*, një perëndeshë e nëntokës përkundrejt së bukurës së qiellit dhe së bukurës së detit,”⁴⁴ e që do të na shërbejë më vonë edhe për një shkallë tjetër krahasimi. E. Çabej, duke theksuar se figura e së Bukurës së Dheut rron ndër Shqiptarë, Grekë, Aromunë, Kurdë, Sirë dhe në përrallën italiane *La Bella del mondo* synon, mendojmë me të drejtë, që këtë figurë ta vejë në lidhje me Odisenë e Homerit, e më konkretisht me magjistaren Qirqenë, duke cekur faktin se shkenca ka theksuar karakterin *ktonik* (tokësor) të Qirqesë.⁴⁵ Kjo afri e të Bukurës së Dheut me Qirqenë e Homerit, për çështjen e shtruar këtu ka rëndësi të madhe, sepse burimi i lashtë dhe karakteri *ktonik* i saj na mundëson që edhe togfjalëshin *Burri i Dheut* që emërton figurën e cekur të legjendës shqiptare, e analogjikisht edhe togfjalëshin *burri i dheut, biri i dheut* me kuptimin e përgjithshëm që e ka sot në shqipe, ta lidhim, në thelb, me karakterin *ktonik* të theksuar me përcaktuesin *i dheut*, që më vonë ka evoluuar drejt një nuancimi semantik ose drejt një desemantizimi.

Nga sa u tha më lart del se, përveç gjymtyrëve veç e veç, edhe strukturën konceptuale të togfjalësheve *E Bukura e dheut* dhe *burri i dheut, biri i dheut*, shkurt edhe vetë strukturën leksiko-semantike e etimologjike të tyre, duhet ta kërkojmë në kohët më të lashta. Theksimin e karakterit *ktonik* me termin-nocionin *dhe* në rol të përcaktuesit e shohim në këta togfjalësha-ndërtime si një kundërvënie mitike-mitologjike të qenieve tokësore atyre të qiellit ose edhe të detit.

Kjo mënyrë e të theksuarit të përcaktuesit *dhe* në togfjalëshat e përmendur të shqipes, e sidomos në togfjalëshat *burri i dheut, biri i dheut*, që në shqipe janë pothuajse të ngurtsuar, aq më parë kur nuk e kemi të njohur ndonjë substituum të përcaktuesit *tokë* ose të të përcaktuarit *njeri, djalë* a ndonjë tjetër, na shpie drejt krahasimeve të tjera së pari brenda shqipes, e pastaj edhe më gjerë, si në sinkroni ashtu edhe në diakroni.

Togfjalësha me semantizëm të karakterit *ktonik*

Që në shkrimet më të vjetra të shqipes ndeshen sintagma dhe kontekste të tjera ku termi-nocioni *dhe, tokë* theksohet si kundërvënie termi-nocionit *qiell*. Përveç betimit të njohur „për këtë gur e dhë” të ruajtur te shqiptarët e të shënuar në Kanunin e Lekë Dukagjinit, për çka bëmë fjalë më parë, betim ky që na rikujton betimin që bënë grekët e vjetër në Gjeanë, duhet vënë dukje edhe betimin e lashtë të malësorëve „per kielh è per dhë”,⁴⁶ ku në mënyrë eksplicite vihen në spikamë si të kundërvëna fjalët *dhe* e *qiell*. Përveç karakterit mitologjik, pagan që ka ruajtur termi-nocioni *dhe* në

⁴⁴ *Po aty*, f. 120.

⁴⁵ *Po aty*, f. 120-121.

⁴⁶ Shih te V a s s a E f f e n d i, *La Vérité...*, f. 33.

betimet e vjetra shqiptare si kundërvënie implicite (p. sh. *për këtë dhe* shënuar nga Hani, vep. e cit., f. 25) ose eksplicite *qiellit*, e që është ruajtur në traditën popullore, folkloike, zakonore të shqiptarëve si dhe në shkrimet më të vjetra të shqipes, qofshin këto edhe me karakter biblik, ndeshet një material i bollshëm gjuhësor ku vihet në dukje kjo kundërvënie. Kështu, në Ungjillin e Pashkëve gjejmë sintagmën *Nqiellshi zot*, që shpjegohet si *zoti në qiell* e nënkupton një kundërvënie „zotit në dhe”, pra njeriut, zotit, sunduesit të tokës ose mbi tokë. Po i përmendim edhe disa shembuj ilustrarivë që i gjetëm në *Antologjinë e Letërsisë së vjetër shqipe* dhe në *Studimet gjuhësore të Çabejt*.⁴⁷

Në disa këngë të moçme shqiptare ndeshet *O i qielsë zot* për „O Celeste Signore”, pastaj *Ngjelshit regj* për „Re del cielo”, *perindi hi qiellit e bidheut* te Buzuku (shih te E. Çabej, v. VI, 11, 43) ku shihet një kundërvënie eksplicite mes qenieve ose zotëruesve të qiellit e të dheut. Te shkrimtarët e vjetër shqiptarë gjejmë shembuj të shumtë, si te Buzuku sintagmën *faqja e dheut, përmbi dhe*, te Lekë Matrënga *qiellë e dheenë, ashtu qiellt si ndëdhee*, te Budi dorë *gjindje përmbij dheet, përmbi faqe të dheut, rregjënien e qiellit*, kurse te Bardhi gjejmë betimin *Per tene zone qi asht mb qiellt* (për *Per Deum nostru quae est super coelos*), te shkrimtarë të tjerë të vjetër shprehjet si *prindit tand të qiellit, Zonj' e madhe e qiellvet e e dheut, qiellorët e përdheekat, njerëzillëku e jo perëndillëku* e ndonjë tjetër, prej të cilave ka edhe me prejardhje biblike. Këtyre do t'u shtonim edhe ndonjë shprehje, lokucion proverbial ose proverb ku theksohet a nënkuptohet kundërvënien mes *dheut* (tokës) dhe *qellit*. Te Marko Boçari ndeshim kundërvënien eksplicite *o'upavoo çauñ qiell e dhe* (shih te E. Çabej, SGJ III, 392), kurse sintagma *faqja e dheut* si shumë e përhapur në shqipe figuron në kontekste të shumta, siç është, bie fjala, shprehja *e zhduku, e shoi, e fshiu nga faqja e dheut, s'e gjen edhe një si ai në faqe të dheut*, me variantin *s'e gjen në të gjithë dheun, s'ka në dhe si ai*. Meritojnë vëmendje edhe shprehjet proverbiale ose proverbat si *i pikur (i pikuar) nga qielli, si i rënë nga qielli, si qielli me tokën, S'ka njeri të rënë nga qielli, Njeriu me shokë është zoti mi tokë*, ku vihet në pah krahasimi ose kundërvënia implicite a eksplicite mes qiellit e tokës (dheut).

Këto kundërvënie të njohura në traditën gjuhësore shqipe dëshmojnë, në njërin anë, për theksimin e karakterit ktonik të njeriut dhe të qenieve që jetojnë mbi dhe, kurse në anën tjetër i shkojnë përkrah pohimit se përcaktuesi *i dheut* në togefjalëshat *burri i dheut, biri i dheut* dhe në ato *Burri i Dheut* dhe *E Bukura e Dheut* nuk është i rastit, duke pasur parasysh si opozicion edhe atë *Bukuri i qiellit* dhe *e Bukura e detit* (shih: *Wörterbuch der Mythologie, II*, Stuttgart, 1973, 7. 470.), por vë në pah karakterin ktonik të tyre me një motivim që duhet të kërkohet thellë në lashtësi, madje edhe në religjionin e lashtë lidhur me hyjnitë ktonike.

⁴⁷ E. Çabej, *Studime gjuhësore VI; Antologji e Letërsisë së vjetër shqipe*, Prishinë, Enti i Teksteve dhe e Mjeteve Mësimore, 1972; Dimitër S. Shuteriqi, *Antologjia e Letërsisë Shqipe*, Prishinë, Enti i Teksteve dhe e Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, 1970.

Struktura konceptuale leksiko-semantike me motivim të lashtë

Për ta shpënë krahasimin tonë të *burrit të dheut*, *birrit të dheut* e më në fund edhe të *Bukurës së Dheut* në lashtësinë ku duket se e kanë vendin, do t'i kthehemi çështjes së emrit të „njeriut” në kulturën e traditën gjuhësore indoevropiane dhe më gjerë.

Fjala shqipe *njeri* si emërtim i përgjithshëm për qenien njerëzore është pa dyshim e vjetër dhe, sikur fjalët e tjera të kësaj kategorie, duhet t'i takojë fondit më të lashtë të vokabularit të shqipes ose parashqipes. Ky pohim gjen mbështetje edhe në faktin se fjala *njeri* e shqipes lidhet me atë *niér*, nga indoevropishtja *ner-* (sansk. *náras*, gr. *άνηρ*), e me *njer*, lat. *noverca*,⁴⁸ përkatësisht *véep* ose *víep* të gegërishtes që është e barabartë me *à-vìp* = skt. *nar*.⁴⁹ Megjithatë, mësa e dimë ne, fjala *njeri* e shqipes nuk përdoret si gjymtyrë e përcaktuar në ndonjë togefjalësh të tipit *burri i dheut*, që do të thotë se nuk e kemi të njohur ndonjë togefjalësh **njeri i dheut*. Ndërkaq, fjalën *njeri* e ndeshim në dokumentet më të vjetra të shqipes së shkruar, siç është Fjalori i Arnold fon Harfit ku kemi *geneyre* (një njeri), kurse F. Bardhi e shënon fjalën *Nierij* të shqipes për atë *vir* të latinishtes. Nga shqipja e folur shënuam sintagmën *njeri i tokës*, pa dyshim si ndërtim i mëvonshëm, që përdoret në Kosovë për të emërtuar njeriun që e punon tokën, që është e lidhur me tokën, që des për tokën, që prind e ka tokën, por edhe me kuptim *njeri i urtë*, *i ndërgjegjshëm*, *modest*, *i thjeshtë*, që e konsideron veten bars me të tjerët.

Mirëpo, për togefjalëshat e shqipes që janë objekt i këtij punimi, rëndësi të veçantë ka çështja e emrit të „njeriut” në gjuhët indoevropiane, gjë që ka qenë objekt studimi i indoevropistit A. Meje (Antoine Meillet).⁵⁰ Sipas këtij studimi del se emri latin *homo* e *homo*, got. *guma*, lit. *žmù* janë të prejardhur nga një bazë (rrënjë) **ghem*, **ghom*, **ghm*, që në indoevropishtë ishte emri kryesor për „tokën”, „dheun” dhe si të tillë, për nga kuptimi, shpiejnë në një kohë kur, për çdo mendim të tipit religjioz, ishte e natyrshme që „njeriu” të kishte domethënie që e dallon prej perëndive, siç janë vdekshmëria, vendbanimi mbi tokë.⁵¹ Ndërkaq, sipas disa fjalorëve etimologjikë merret baza e i.e. *khem* me kuptim *tokë*, *dhe* që ka dhënë në sanskr. *ksam-*, gr. *khamai* (=në tokë); *kthôn* (=tokë, dhe), lat. *lumus* prej nga *homo* që do të thotë tokësori, got. *guma* (=njeri).⁵² Nga kjo shihet se emri i „njeriut” në disa gjuhë indoevropiane, që nga kohë më të vjetra, lidhet etimologjikisht me konceptin-termin „dhe, tokë”, me një bazë të vjetër me domethënie *dhe*, *tokë*, ose me një përcaktim *i dheut i tokës* ose cilësim *tokësor*. Derisa emri *njeri* i shqipes nuk na shpie në ndonjë etimologji, e cila

⁴⁸ Shih te E. Ç a b e j, *Studime gjuhësore VI*, f. 149.

⁴⁹ Shih te D. C a m a r d a, *vep. e cit.*, I, f. 17.

⁵⁰ Shih te A. M e i l l e t, *Linguistique historique et linguistique générale*, Paris, Honoré Champion, 1965, f. 272-280.

⁵¹ P o a i, *po aty*, t. 276.

⁵² Shih te Grandsaignes d'Hauterive, *vep. e cit.*, f. 91.

këtë fjalë do ta afronte me konceptin-termin „dhe, tokë”, emri ilir *Agron* të cilin disa dijetarë e shpjegojnë me kuptim „tokë bujqësore”, „kullotë”⁵³ ka gjithsesi rëndësi edhe për gjuhën shqipe ose parashqipe, përkatësisht për antroponiminë ilire. Ndoshta nuk është e tepërt të cekim me këtë rast edhe disa emra të vjetër familjesh të formuar me mjetet e shqipes, që për bazë kanë fjalët *mal, tokë*.⁵⁴

Meqë del mjaft i qëndrueshëm fakti se në shoqërinë dhe kulturën indoevropiane si dhe në religjionin indoevropian ka ekzistuar një „koncept”, „motiv” ose „nënshtresë” psikologjike që emrin e njeriut ta lidhë me emrin e „dheut, tokës”, siç dëshmohet me emërtimin e „njeriut” në disa gjuhë indoevropiane, me dallim prej disa të tjerave që mund ta kenë humbur, zëvendësuar me një tjetër ose motivuar ndryshe,⁵⁵ na duket sa ka mbështetje të mjaftueshme që, në mungesë të dëshmive të hershme të shkruara, të rindërtohet edhe ndonjë kompozitë ose togfjalësh për njeriun si qenie e dheut a sundues i dheut, tokës, kur dihet se kompozitat i takojnë fondit më të hershëm të zhvillimit të gjuhëve në përgjithësi.⁵⁶ Në këtë mënyrë, duke u nisur prej një rrafshi sinkronik të shqipes së sotme kah një prerje diakronike relativisht të vjetër, e duke pasur parasysh faktin se frazeologjitë e togfjalëshat zënë vend në fjalorët e mëvonshëm të shqipes, kurse përdorimi i tyre në shkrimet e vjetra është varur nga rasti, konteksti e tematika, mund të na lejohet që brenda shqipes, si gjuhë indoevropiane, përkatësisht brenda parashqipes, të ketë vend për një nënshtresë psiko-linguistike, etnolingvistike, antropolingvistike, që në fazën më të hershme të zhvillimit të kësaj gjuhe në gjiun e gjuhëve indoevropiane t’i rindërtojmë togfjalëshat e tipit **burri i dheut, *biri i dheut, *E Bukura e Dheut* si koncepte e shenja gjuhësore, pa marrë parasysh ndryshimet morfo-fonologjike e semantike që mund t’i kenë pësuar deri në ditët tona. Në aspektin e raportit të antropologjisë e linguistikës, duhet të shohim një lidhje në mes të të gjykuarit dhe modelit gjuhësor, lidhje kjo e zbuluar nga filozofia e vjetër greke e hindase.⁵⁷ Duke pranuar një raport të tillë, padyshim të vjetër dhe të mbështetur në konceptin ose „vizionin e botës” në shoqërinë indoevropiane, dhe më në fund „vizionin religjioz” të saj, na duket se ka baza që fjalën e vjetër *dhe* si përcaktues dhe ato po ashtu të vjetra *burrë, bir*, si nocione-terma bazë të institucionit shoqëror e etnik më të lashtë, si të përcaktuar, t’i bartim në një kohë të lashtë qoftë si shenja gjuhësore në përgjithësi, qoftë si koncepte jashtëgjuhësore, psikologjike, shoqërore, religjioze që patjetër duhet ta kenë pasur edhe realizimin në shenja gjuhësore. Prandaj ka baza dhe gjasa që këto fjalë në strukturën e varësisë dhe funksionit të tyre brenda kompozitave ose togfjalëshave të cekur e edhe vetë togfjalëshat

⁵³ Shih shënimet nën 36.

⁵⁴ E. Ç e b e j, *Studime gjuhësore VI*, f. 9-10.

⁵⁵ Shih për emrin e njeriut edhe në *Opća enciklopedija 2*, Zagreb, JLZ, 1977, f. 212.

⁵⁶ Shih te B. L. W o r f, *Linguistique et anthropologie*, Paris, Denoël/Gonthier, 1969, f. 36.

⁵⁷ P o a i, *po aty*, f. 35.

burri i dheut, biri i dheut si dhe *E Bukura e Dheut* t'i konsiderojmë të një burimi të lashtë-antik, duke marrë parasysh, mes tjerash, jo vetëm strukturën leksiko-semantike, por edhe atë sintaksore me një rend të gjymtyrëve që dëshmon edhe për një vazhdimesi iliro-shqiptare.⁵⁸

Kur e kemi parasysh faktin se një „vizion”, „psikologji” e tillë në një mënyrë mund të krahasohet me një dukuri të njohur në shoqërinë indoevropiane, dhe se ndërtime të ngjashme ndeshen edhe në këngët homerike, nuk është larg mendsh që togfjalësha të tillë të ketë pasur edhe në parashqipe. Përveç emrit „njeri”, etimologjia e të cilit në disa gjuhë indoevropiane afrohet me fjalën „dhe”, „tokë”, indoeuropeisti A. Meje, duke bërë fjalë për religjionin indoevropian, vë në dukje dallimin thelbor mes njeriut dhe zotërave ose perëndive, përkatësisht mes njeriut si qenie tokësore dhe vdekatore dhe hyjnive a perëndive si qiellorë e të pavdekshëm.⁵⁹ Kështu, vazhdon Mejeu, këto dy nocione të Homeri ceken shpesh ashtu që njeriu, në dallim prej perëndive, emërtohet ose „tokësori” (lexo i *dheut*, i *tokës* R.U.) ose „vdekatari”.⁶⁰

Në kohët më të vonshme, lidhja e emrit të njeriut në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me fjalën „dhe”, „tokë” në gjuhë e kultura të ndryshme është edhe me karakter biblik. Kështu ka pasur synime që në mënyrë analogjike të jepen edhe interpretime apologetike të shkollave filozofike e religjioze, se *homo* rrjedh prej *humus*, duke i dhënë këtij emri karakter biblik gjoja se „njeriun e ka krijuar zoti prej baltës, tokës ose lymit të dheut”.⁶¹ Në traditën folklorike-gojore shqiptare është ruajtur një dialog ku fjala *dhe* përdoret figurativisht për emërtimin e njeriut, qenies njerëzore e ku përdoret edhe togfjalëshi *I pari i dheut*⁶² që nënkupton sunduesin e një krahine, vendi, toke.

Sido që të jetë, determinimi i njeriut me nocionin e *dheut*, e *tokës*, ose edhe etimologjia e emrit të njeriut në disa gjuhë indoevropiane, duhet të shpiejë në kohët më të lashta, si koncept i qenies lindja, jeta e së cilës është e lidhur me dheun, tokën, si koncept i qenies që jeton, zotëron mbi dhe, mbi tokë, si kundërvënie qenieve misterioze, shpesh të imagjinuara e të panjohura që jetojnë në qiell, si kundërvënie qiellorëve ose atyre të qiellit. Këto vizione, substrate psikologjike të karakterit ritual-religjioz duhet të kenë qenë

⁵⁸ Shih për këtë fenomen edhe te J o r g j i G j i n a r i, *Mbi vazhdimësinë e ilirishtes në gjuhën shqipe* në: Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve, Tiranë, USHT-Inst. i Hist. dhe i gjuhësisë, 1969, f. 178.

⁵⁹ Shih te A . M e i l l e t, *Linguistique historique...*, f. 328.

⁶⁰ P o a i, *po aty*.

⁶¹ Shih P i e r r e G u i r a ū d, *L'Etymologie*, Paris, P. U. F., 1972, f. 16.

⁶² Sipas një tradite gojore në një përallë shqipe (sipas kumtimit të M e h m e t H a l i m i t e S h a q i r B a r a n i t, punonjës shkencorë të Institutit Albanologjik të Prishtinës), përmendet dialogu ndërmjet një sunduesi dhe një bujku si vijon: -Puna marë o *dhe*, që rrotullon *dhe!* -Marë paç o *dhe* e *I Pari i dheut!* (nënvizimet tona R. U.). Këtu, siç shihet, fjala *dhe* përdoret edhe me kukptim figurativ „njeri”. Edhe në tregimin e shënuar *Lavërtari dhe Mbreti* (shih A . Ç e t t a, *Prozë Popullore nga Drenica I*, Prishtinë, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 1979, f. 225) ndeshet dialogu: -Puna marë more punëtor i dheut! -Marë paç suni i dheut! Edhe F Bardhi për *princeps* të lat. jep *I pari dheut* të shqipes (shih *Fjalorin* f. 109.)

preokupim i lashtë i shoqërisë indoevropiane dhe asaj antike-pagane sa edhe komunikimi më i hershëm i njeriut, kur qielli e toka janë kuptuar dhe paraqitur si dy antipode, ku fshehtësitë e fenomenet e pashpjegueshme iu kanë mveshur qiellit dhe fuqive qiellore. Kështu, në psikën e njeriut të atëhershëm, përveç botës konkrete të njeriut të tokës, dheut, është krijuar edhe bota e hyjnive të plotfuqishme qiellore, të pavdekshme.

Sa i takon termit *tokë*, i cili merret shpesh si sinonim i atij *dhe*, e ka gjasa të jetë më i vonshëm, sepse edhe dëshmohet më vonë se fjala *dhe*, shihet se nuk e ka zëvendësuar fjalën *dhe* në togfjalëshat e tipit *burri i dheut*, edhe pse na del si sinonim i fjalës *dhe* në disa shprehje që i përmendëm më herët. Sipas një kumtimi me gojë që e cekëm më lart njihet vetëm një sintagmë *njeri i tokës* me kuptim të ngushtë. Në anën tjetër kjo fjalë del si produktive në mbiemrin *tokësor*, i cili përdoret në sintagma siç janë *heronj tokësorë*, *ndjenjë tokësore*, *jetë tokësore* e ndonjë tjetër. Na merr mendja se edhe ndërtimet *nëna tokë* ose *toka mëmë* duhet të jenë po ashtu më të vonshme, siç duhet të jenë edhe kompozitat *atdhe*, *mëmëdhe*, aq më parë kur dihet se te shkrimtarët e vjetër shqiptarë për këtë nocion ndeshim fjalën *dhe*, *dheu*+*ndonjë përcaktues* ose thjesht *dheu* me kuptim *atdheu*.

Togfjalëshat me përcaktuesin „botë” të tipit „burri i botës”

U pa se në togfjalëshat e përmendur të tipit *burri i dheut* nuk ka raste të krijimit të ndonjë mbiemri rrjedhojë me ndërtim prapashtesor nga fjala *dhe*, as zëvendësim të kësaj fjale me atë *tokë* në rolin e përcaktuesit. Megjithatë, sa i takon togfjalëshit *burri i dheut*, *biri i dheut* në shqipe mund të ndeshet substitiuimi i përcaktuesit *botë*, pra përdoren togfjalëshat *burri i botës*, *biri i botës* e madje edhe *gruaja e botës* që e ndeshim edhe në Fjalorin shqip-greqisht të Kristoforishit. Fjala *botë* e shqipes, gjykuar sipas etimologjisë së saj,⁶³ duhet të jetë e më vonshme se ajo *dhe*, e rrjedhimisht edhe togfjalëshat e sipërshtënuar me përcaktuesin *botë*. Në këta togfjalësha përcaktuesi *botë* ka më parë kuptimin e *rruzullimit*, por edhe të *popullit*, *njerëzve*, *gjindes*. Këta togfjalësha dalin me semantizëm kryesisht mospërfillës siç u cek në fillim të këtij punimi.

Duhet cekur se në të folmen e Opojës sot nuk ekziston fjala *dhe*, por vetëm fjala *botë* (sipas informatës së dialektologut Mehmet Halimi).

Përfundim për një rindërtim

Lidhur me çështjen e shtruar në këtë punim mund të pohohet, me mjaft gjasa, se togfjalëshat *burri i dheut*, *biri i dheut*, në radhë të parë si struktura konceptuale e padyshim edhe si struktura leksiko-semantike

⁶³ Për etimologjinë e kësaj fjale shih te E . Ç a b e j, *Studime gjuhësore I*, f. 75.

psikolinguistike, duhet t'i takojnë motivimit ose etimologjisë që zë rrënjë në kohët më të lashta të religjionit indoevropian e të shoqërisë indoevropiane, duke u përdorur me nuancime të mundshme konceptuale prej epokës antike e biblike, kah mesjeta e deri në ditët tona.

Për ta pohuar një gjë të tillë duhet të vemë në spikamë, në radhë të parë, zhvillimin e shqipes si gjuhë indoevropiane dhe në kontekstin e gjuhëve indoevropiane me të gjitha reliktet e tringut të përbashkët. Depërtimin e thellë në lashtësi, sa i takon motivimit etimologjik të togfjalëshave të tipit *burri i dheut* na mundëson religjioni indoevropian me rritulet gjegjëse, etimologjia e emrit „njeri” në disa gjuhë indoevropiane dhe përdorimi në lashtësi i koncepteve-termave „dhe, tokë” dhe i koncepteve-termave lidhur me „njeriun”, jetën shoqërore, fisnore, afrinë familjare.

Një vazhdimësi të kësaj kulture të lashtë e ndeshim në emrat e hyjnive të vjetra, në relikte e betime të ritualit pagan dhe në formulat homerike, ku njerëzit, në dallim prej perëndive ose hyjnive si të pavdekshëm e qiellorë, quhen vdekatarë e tokësorë (lexo „të tokës, të dheut”). *Burri i dheut* e veçanërisht *biri i dheut*, në mënyrë analogjike, na rikujton gjurmët e mitologjisë antike ku Titajtë, Qiklopët konsideroheshin të bijtë e Gjeas (tokës-nënë) dhe në një masë edhe kompozitën e trakishtes *Ziper* (Zi+per) „i Zeusit bir”.⁶⁴ Po me këtë vazhdimësi, ndonjë sundues në antikë (si Aleksandri i Madh) e konsideronte veten *biri i zotit*, kurse në latinishten klasike ndeshet kompozita e llojit *tatpuruşa* siç është ajo *terrae filius* („i dheut, i tokës bir” R. U.)⁶⁵ që si strukturë leksiko-semantike përkon plotësisht me togfjalëshin e shqipes *biri i dheut*, e del me një semantizëm të përgjithshëm më të nuancuar dhe më të afërt me *biri i botës* ose *burri i botës*. Në anën tjetër, sa i takon topikës dhe lidhjes sintaksore, në togfjalëshin *biri i dheut* të shqipes, në dallim prej gjuhëve të tjera indoevropiane,⁶⁶ kemi një topikë të kundërt, ku gjymtyra e dytë është në rolin e përcaktuesit, kurse gjymtyra e parë në rolin e të përcaktuerit, gjë që, na merr mendja, ka rëndësi për hetimin e ndërtimit autonom sintaksor të togfjalëshave të tipit *burri i dheut* të shqipes në gjiun e gjuhëve indoevropiane, e ku përjashtohet ndonjë ndikim i drejtpërdrejtë nga ndonjë kompozitë ose togfjalësh i këtij lloji, të gjuhëve që u zunë në gojë, e me të cilat shqipja ka qenë në kontakte shekullore.

Emërtimet-togfjalëshat e kategorisë tjetër siç janë *Burri i Dheut* dhe *E Bukura e Dheut* si figura përrallore-folklorike dallohen me përcaktuesin *i, e dheut* i cili del më i qartë e më konkret si asociacion konceptul ose leksiko-semantik për emërtimin dhe përcaktimin e qenieve që i takojnë *dheut, tokës, ose që*, në një mënyrë ose tjetër, vihen në raport me konceptin e *dheut, tokës*. Meqë *E Bukura e Dheut*, siç u pa më lart, në një mënyrë afrohet me Qirgenë e Homerit, vetvetiu rrjedh se edhe zberthimi dhe

⁶⁴ Shih Jorgji Gjinari, *Mbi vazhdimësinë e ilirishtes...*, f. 178.

⁶⁵ Shih te Felix Gaffiot, *Dictionnaire illustré latin-français*, f. 667.

⁶⁶ Te F. Bardhi (Fjalori, f. 97) gjejmë për *Solis filius* = I biri i diellit. Shih lidhur me këtë çështje E Çabej, *Studime gjuhësore VII*, f. 81.

interpretimi i motivimit të këtij emërtimi mund të lidhet me një kohë të lashtë dhe duhet të këtë karakter mitik-mitologjik.

Këto dy emërtimet e fundit, me strukturë dhe ndërtim të tipit *burri i dheut*, por me një semantizëm të nauncuar, ku përcaktuesi *dhe* ngërthen një semantizëm më të tejdukshëm, na japin dorë që të depërtojmë më lehtë në motivimin më të hershëm etimologjik të togfjalëshit *burri i dheut*, *biri i dheut*, në kohën kur përcaktuesi „*i dheut*” do të ketë pasur semantizëm më konkret, me një motivim të ngjashëm ose të afërt me semantizmin „*i, e dheut*” si përcaktues në emërtimet folklorike të zëna në gojë.

Në rrjedhën e kohës, përcaktuesi *i dheut* në togfjalëshat *burri i dheut*, *biri i dheut* duhet të këtë pësuar një desemantizim, meqë sot nuk hetohet ndonjë asociacion ose motivim i qartë konceptual i „*dheut, tokës*” në gjymtyrën e dytë *dhe* në rolin e përcaktuesit.

Nga sa u tha më lart, mendojmë se ekzistojnë baza për supozim se në parashqipe duhet të këtë ekzistuar koncepti kompozitor i një togfjalëshi të llojit * *burri i dheut*, * *biri i dheut* e më në fund edhe koncepti-emërtimi i tipit * *E Bukura e Dheut* jo vetëm si koncept ekstralinguistik e psikologjik, por edhe si strukturë leksiko-semantike ku elementet „*dhe*”, „*burrë*”, „*bir*”, „*E Bukura*”, si koncepte-terma themelore, duhet t’i takojnë fondit më të lashtë të shqipes a të parashqipes ose të indoevropishtes, e më në fund duhet të jenë gjurmë gjuhësore e shoqërisë së lashtë indoevropiane dhe e religjionit indoevropian e antik. Një bazë e tillë institucionale, antropologjike, psikologjike është e arsyeshme të jetë trashëguar jo vetëm si ritual, koncept mitologjik a mitik, por edhe si relik gjuhësor edhe në shqipen e sotme.

Kur kemi parasysh se prej kulturës së lashtë indoevropiane është ruajtur deri më sot *rituali i kuvadës*,⁶⁷ një seri ritualesh me karakter pagan e antik të trashëguar në formula betimi a mallkimi të shqipes, pastaj hyjninë „*Dheu mëmë*” që si pandan i Demetrës greke rindërtohet në atë ilire **ghdhōm māter*⁶⁸ si dhe një fond fjalësh shqipe të trungut indoevropian, as gjurmët e ndonjë togfjalëshi të tipit * *burri i dheut* që mund të lidhet me motive religjioze, antropologjike, psikologjike të një kohe të lashtë e primitive nuk mund të përjashtohet lehtë. Këtë synuam ta dëshmojmë me një prerje sinkronike të materialit gjuhësor dhe me një depërtim në diakroni, duke bërë një lloj rindërtimi të togfjalëshave *burri i dheut*, *biri i dheut*, *E Bukura e Dheut* në gjiun e parashqipes dhe të lashtësisë indoevropiane.

⁶⁷ Shih lidhur me këtë më gjerësisht E . Ç a b e j, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, Rilindja, 1976, f. 43.

⁶⁸ Shih lidhur me këtë: X . D e l a m a r r e, *Vep. e cit.*, f. 73.

Ruzhdi Ushaku

On Lexical-Semantic and Etymological Structure of the Type of the Albanian Phrase „Burri i Dheut”

-A Possibility for Reconstruction in pre-Albanian-

S u m m a r y

The phrases *Buri i dheut* (liter. „the man of the Earth”), *biri i dheut* (liter. „the son of the Earth”) occupy an important and stable position in the general fund of Albanian phrases. They have lexically-semantic structures and dense syntactic relations, almost petrified, and they express a melted notion. The modifying element „i dheut” (of the Earth) has lost its basic meaning as a lexical element of „dheut, tokës” (earth, land) and has undergone a kind of desemantism, because one cannot observe any of their direct relations or associations with „dheu”, „toka” in the general conception of these phrases. Analogically, this phenomenon is also seen in the phrases *burri i botës*, *biri i borës* with another semantic nuance, where the element *botë* (world) is also desemantized.

On the other hand, in the tradition of Albanian oral folklore there are known figures of mythic fables under the name *Burri i Dheut* and *E Bukura e Dheut* (The Beauty of the Earth) with identical lexically-semantic structures and syntactic relations, respectively, similar ones. However, the lexical element *dhé* in the function of a modifier in these nominations maintains in a clearer and more transparent way the basic concept of „dheu”, „toka”, since, as it is known, the general conception of folklore figures *Burri i Dheut* and *E Bukura e Dheut* embraces creatures in which a conceptual association and relationship with the Earth, the land, is observed. The figure of *E Bukura e Dheut* has a similar lexical-semantic structure also within the other Balkans peoples, but mainly with the headword „Earth” in the conception of the „world”.

The motivation of the lexical-semantic structure of nominalization *Burri i Dheut*, and particularly *E Bukura e Dheut* as a folklore figure, so much spread out among other peoples and comparable with Homer’s Circe provides quite a good base to get through to an ancient etymological motivation with chthonic character of the phrases *burri i dheut*, *biri i dheut*, *biri i dheut*, respectively, as well.

For an interpretation of the phrases *burri i dheut*, *biri i dheut*, as structures motivated in ancient times and preserved in the form we know them today, the etymology of *dhé* in the function of a modifier and of *burri*, *biri*, in the functions of headwords is of primary importance. These Albanian words, according to some facts recognized by present knowledge and according to some new and additional data offered in this paper, come out with an ancient etymology leading back towards the Indo-European trunk.

Bearing in mind these data and the etymological motivation of the name of the „man” that in some Indo-European languages is linked to the concept „earth”, „land”, it is possible to see in the modifier *i dheut* in these phrases the chthonic character of human beings, on the one hand, and an understandable confrontation of outside world being, on the other hand. We can see this opposition in a clearer way in Homeric formulas where people, differing from the creatures called „mortless”, are otherwise called „dying” of „of the earth”. A similar implicit or explicit opposition can be observed in continuation from ancient and the time of the Bible up to nowadays, while in spoken and written Albanian—from older times.

The Indo-European religion and rituals with paganic character preserved in curses, oaths, addressed to the earth that we met within Albanians and some pandeans in the ancient mythology of the other Balkanic peoples, on the one hand, and the continuous use of formulas, composites or word groups analogically with the other old languages and civilisations where the chthonic character is stressed explicitly and implicitly, serve as a basis for us to rebuild the word groups of the type **burri i dheut*, **biri i dheut*, **E Bukura e Dheut* and similar ones in pre-Albanian as well, whose traces we can also meet nowadays in the language and the oral tradition of Albanians.

kreu në Dibër, kurse klasat e tjera dhe maturën i kreu në Manastir. Këtë arsim, që në atë kohë nuk ishte i pakët, Stërmilli e mori në gjuhën turke, por ai, qysh si nxënës i shkollës fillore në gjuhën turke, e mësoi tinëzisht edhe alfabetin e gjuhës shqipe nga Azis Menzelxhiu dhe filloi të lexojë libra edhe në gjuhën shqipe. Intelektualët patriotë të kohës, si Hoxhë Voka (Said Najdeni), vëllezërit Strazimiri, Josif Bageri, Dervish Hima, Azis Menzelxhiu e të tjerë ndikuan në arsimimin dhe në edukimin e brezit të ri, pra edhe në arsimimin e në edukimin e Haki Stërmillit. Abetarja e Said Najdenit ishte përhapur nëpër Dibër që në vitin 1879, kurse në vitin 1888 Hoxhë Voka hapi tinëzisht shkollën e parë në Dibër,¹ e cila i zhvillonte mësimet nëpër bodrume e dhoma të fshehta të shtëpive dibrane.

Luftërat ballkanike u sollën shumë të këqija banorëve të një pjese të Ballkanit. Ushtria e borgjezisë serbe hyn në Dibër. Ajo sillej keq me banorët e qytetit e të rrethinës. Jeta e banorëve të Dibrës e të rrethinës ishte e rëndë, kështu që shumë familje u detyruan të braktisin trojet e veta e të shpërngulen. Këtë „fat” e pat edhe familja e Stërmillit, e cila, së bashku me shumë familje dibrane, më 1913 emigroi në Shqipëri. Së pari familja Stërmilli vendoset në Elbasan e mandej në Durrës, ku Hakiu zuri punë në administratën shqiptare. Hakiu kishte dëshirë për të vazhduar shkollimin universitar diku në ndonjë shtet të Evropës, por kjo dëshirë i rrënohet meqë si kujdestar i familjes, pasi i kishte vdekur i ati, kurse vëllai i madh — Musaja iu kishte vra më 1912 në luftërat ballkanike, detyrohet të punojë për të mbajtur familjen. Përveç kësaj barre, Hakiut tetëmbëdhjetëvjeçar i bie edhe një barrë shumë fish më e rëndë. E ëma dhe farefisi i bënin presion Hakiut që të pranojë martesën me të vejen e të vëllait të vrarë. Tri vjet i bëri rezistencë kësaj martese, tri vjet luftoi me të gjithë të afërmit derisa më në fund u detyrua të martohet me të vejen e Musasë, e cila kishte edhe një djalë 3-4 vjeçar. Tashti u varrosën edhe më thellë shpresat e Hakiut për të vazhduar shkollimin e mëtejshëm në Evropë edhe pse Qeveria e Ismajl Qemalit i kishte dhënë një bursë për këtë gjë. Familja e Stërmillit bredhi nëpër disa vende të Shqipërisë — jetoj në Elbasan, në Tiranë në Durrës, në Peshkopi, në Mat etj. Në Mat Stërmilli qe sekretar i nënprefekturës, kurse viti 1918, atëherë kur forcat okupuese austrohun gareze tërhiqen nga Mati, e gjeti Stërmillin zv. nënprefekt. Pasi mori fund okupimi austrohunarez, Mati u plaçkit nga Esad Toptani e njerëzit e tij, kurse Stërmilli detyrohet të largohet prej andej dhe shkon në Burgajet ku zhvillon një aktivitet të madh patriotik. Në saje të autoritetit që gëzonte, Stërmilli arriti të pajtojë shumë gjaqe në Burgajet e rrethinë.

Kur shërbente në Mat, Stërmilli u miqësua shumë me Zogun e me familjen e tij: „Me Ahmet Zogun, qysh kur isha në Mat, isha miqësue dhe ai tregohesh mirënjoftës kundrejt meje për shkak se ia kisha mësue të motrat dhe ia kisha mbrojtë familjen kur ai ndodhesh jashtë Shqipërisë. Por kjo miqësi nisi me u tronditë kur fillova me diktue intrigat e tij që e çuan në tradhti..., politika e tij e jashtme e shumë të tjera më banë me i shkëputë për-

¹ S.T e m o, ...Said Najdeni (Hoxhë Voka), „8 Nëntori”, Tiranë, 1980, f. 22 e 24